



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 228/4 Prot.

Tiranë më 8.03.2019

REKOMANDIM

Nr. 21, datë 8.03.2019

PËR KONTROLLUESIN “AUTORITETI SHËNDETËSOR RAJONAL TIRANË”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 pika 1, gërma a/1, dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë”,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.58 datë 20.02.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe shkresës nr.257 Prot., datë 05.02.2019, nëpërmjet të cilës kërkohet mbështetja e Zyrës së Komisionerit sa i përket procesit të monitorimit të “Shtëpive të Mbështetura” me sistemin e video-sruvejimit (CCTV), u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit “Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë”, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Nga verifikimi i kryer në vend, rezultoi se:

1. Kontrolluesi ka “Njoftuar” Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Nga verifikimi i “Njoftimit” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat kontrolluesi është përgjegjës, është konstatuar se është i nevojshëm përditësimi i tij sa i përket “kategorive të subjekteve të të dhënave”, “kategoritë e të dhënave personale që përpunohen”, “qëllimet e përpunimit” etj., referuar “Formularit të Njoftimit”.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr.9887/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, i ndryshuar: *"...Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë"*.

2. Kontrolluesi informon subjektet e të dhënave "nëpunës", "pacientë", "vizitorë", etj., nëpërmjet tabelave informuese, mbi prezencën e sistemit të video-survejitimit (CCTV). Tabelat informuese nuk janë në përputhje me formatin e miratuar sipas Udhëzimit nr.3/2010 të Komisionerit *"Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejitimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera"*.

Konstatimi sa i përket informimit jo të plotë mbi qëllimin e përpunimit të të dhënave, ushtrimit të të drejtave, të drejtën e ankimit të subjekteve të të dhënave etj., gjatë përpunimit të të dhënave personale imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-survejitimit (CCTV) nga kontrolluesi, përbën shkelje administrative të nenit 18, të ligjit dhe Udhëzimit nr.3/2010 të Komisionerit *"Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejitimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera"*.

3. Kontrolluesi nuk ka hartuar rregullore mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video dhe funksionimin e sistemit të video-survejitimit (CCTV), në ambientet e *"Shtëpive të Mbështetura"*.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 2/1, të nenit 27, të ligjit nr.9887/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, i ndryshuar: *"Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera."*

Duhet kuptuar drejt nga kontrolluesi rëndësia që ka hartimi i rregullores dhe udhëzimeve specifike për operatorët e autorizuar, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-survejitimit (CCTV), me qëllim marrjen e masave organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i kontrollit hartoi dhe nënshkroi në prani të palëve procesverbalin e hetimit administrativ.

Lidhur me konstatimet e grupit kontrollit, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk patën kundërshtime, por u shprehën se: *"Nga institucioni do ndërmerren masa për rikuperimin e tyre dhe standardizimin e procesit të monitorimit me sistem kamerash në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar"*.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 21, 27, 29, 30, 31 dhe 32 pika 1 të ligjit nr.9887/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi "Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë" në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e "Njoftimit" në lidhje me "kategoritë e subjekteve të të dhënave", "kategoritë e të dhënave personale që përpunohen", "qëllimet e përpunimit" etj.
2. Kontrolluesi "Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë", në zbatim të nenit 18, të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, të ketë në vëmendje informimin e subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV) nëpërmjet tabelave informuese, sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri me Udhëzimin nr.3/2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera".
3. Kontrolluesi "Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë", në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.3/2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", të hartojë rregullore për përpunimin e të dhënave "imazhe-video" nëpërmjet sistemit të video-surveimit (CCTV), në ambientet e "Shtëpive të Mbështetura".
4. Kontrolluesi "Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë", të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
5. Në rast mos përbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 8.03.2019.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

